

Periudha 3-javore e masës së përkohshme të Kushtetueses vlerësohet e gjatë



Faqe 2

Grenell: Osmani po gënjen, bashkë me Kurtin ishin ekip i tmerrshëm



Faqe 2

Zbatimi i Ligjit për të Huajt dhe i atij për Automjetet pritet të nisë të hënën



Faqe 4

Penalltia e "shpëton" Barcelonën, Bayerni e Atletico me fitore të thella



Faqe 16

e mërkurë • 11 mars 2026

Numri 10298

KOHA DITORE

www.koha.net



KOSOVA VAZHDON TË PENALIZOHET SI PASOJË E TELASHEVE NË SKENËN POLITIKE

Komisionerja Kos shtyn vizitën në Kosovë shkaku i krizës institucionale

Një vizitë e Komisioneres Kos, ndonëse nuk ishte konfirmuar data zyrtarisht, ishte planifikuar të zhvillohej këtë javë, më saktësisht të enjten, por tash sipas burimeve evropiane ajo është shtyrë. Nga burimet në Bruksel mësohet se arsyeja e mosrealizimit të vizitës së Komisioneres Kos në Prishtinë është konfuzioni që është krijuar pas dështimit të zgjedhjes së presidentit dhe pas vendimit të presidentes Osmani për shpërndarjen e Kuvendit

Augustin Palokaj

BRUKSEL, 10 MARS - Komisionerja e Bashkimit Evropian për zgjerim, Marta Kos, nuk do ta realizojë vizitën e saj të parë në Kosovë gjatë kësaj jave. Për këtë, sipas burimeve nga BE-së, Komisionerja Kos e ka njoftuar edhe kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti në një bisedë telefonike të cilën e ka zhvilluar të hënën.

"Gjatë një bisede telefonike me kryeministrin Albin Kurti, Komisionerja Kos i tha atij se do të shtyjë vizitën e planifikuar në Kosovë në rrethanat e zhvillimeve të fundit. Kryeministri Kurti shprehu përkushtimin e tij për rrugën drejt BE-së dhe reformave të lidhura me BE, posaçërisht në kuadër të planit të rritjes për Kosovën. Komisionerja Kos ka për qëllim të udhëtojë në Prishtinë në rastin më të hershëm të mundur", ka thënë një zëdhënës i Komisionit Evropian.

Një vizitë e Komisioneres Kos, ndonëse nuk ishte konfirmuar data zyrtarisht, ishte planifikuar të zhvillohej këtë javë, më saktësisht të enjten, por tash sipas burimeve evropiane ajo është shtyrë.

Nga burimet në Bruksel mësohet se arsyeja e mosrealizimit të vizitës së Komisioneres Kos në Prishtinë është konfuzioni që është krijuar pas dështimit të zgjedhjes së presidentit dhe pas vendimit të presidentes Osmani për shpërndarjen e Kuvendit.

Sa i përket këtyre zhvillimeve, në BE vetëm kanë përsëritur se "me keqard-

hje marrin në dijeni atë që ka ndodhur" dhe se "jemi në pritje të vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës".

Vizita e Komisioneres Kos në Kosovë, po të ishte realizuar, ka pasur për qëllim edhe të dëshmojë se janë përfunduar të gjitha procedurat për heqjen e masave ndëshkuese ndaj Kosovës dhe se tash pritet një dinamike e re në raportet mes Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Kosova është i vetmi vend i rajonit të Ballkanit Perëndimor të cilin Komisionerja Kos nuk e ka vizituar asnjëherë prej kur para 14 muajsh ka marrë postin si anëtare e Komisionit për çështje të zgjerimit. Të gjitha vendet e tjera i ka vizituar, disa edhe më shumë se një herë.

Arsyet të cilat më së shpeshti përmendeshin se pse Kos nuk e ka vizituar akoma Kosovën kishin të bëjnë edhe me masat, por edhe me krizën politike më shumë se njëvjeçare gjatë së cilës në Kosovë nuk kishte institucione me legjitimitet të plotë.

Pas konstituimit të Kuvendit pas zgjedhjeve të fundit dhe zgjedhjes së qeverisë, në BE menduan se do të ketë kushte për një dinamikë të re në raporte në mënyrë që të kapet hapi në disa fusha ku Kosova ka humbur shumë kohë për shkak të masave dhe për shkak të ngërçit politik. Por tash kur në Kosovë janë paraqitur paqartësi të reja, në BE thonë se nuk kanë çfarë të bëjnë derisa këto procedura të brendshme në Kosovë të sqarohen.

© KOHA Ditore



Foto: AP

Teheran, 10 mars – Tensionet në Lindjen e Mesme janë përshkallëzuar ndjeshëm të martën, pasi që Irani i ka intensifikuar sulmet raketore ndaj Izraelit dhe ndaj shteteve arabe të Gjirit. Veprimi është pasuar me reagim të ashpër nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Pete Hegseth, e ka paralajmëruar Iranin me valë të re dhe intensive sulmesh përbrenda territorit të tij

NJË METËR KATROR I BANESAVE NË PRISHTINË KA RASTE KUR SHITET EDHE MBI 2500 EURO

Çmimet e banesave "në qiell", vihet në dyshim raporti i ASK-së

Elda Islami

PRISHTINË, 10 MARS – Çmimi i banesave në Prishtinë ka vazhduar të rritet, pasi ka raste që një metër katror shkon deri mbi 2500 euro.

Sipas të dhënave të agjencive për patundshmëri edhe në qendrat e tjera të Kosovës, vit pas viti është shënuar rritje e çmimit të banesave.

Agjencia e Statistikave të Kosovës këtë vit ka publikuar Indeksën e Çmimeve të Pronave të Banimit, i cili tregon dinamikën e rritjes së tregut të patundshmërive në Kosovë.

Të dhënat për periudhën 2018–2025 tregojnë se çmimet e banesave

janë rritur pothuajse çdo vit.

E vetëm për tremujorin e katërt të vitit 2025 në Rajonin e Prishtinës, çmimet janë rritur për 4.9%, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024, sipas ASK-së.

Mirëpo, njohës të fushës vënë në dyshim të dhënat e ASK-së, duke thënë se çmimet në realitet janë shumë të larta sesa pasqyrohen në raport.

"Hulumtimet e bëra nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, për mua, nuk janë kredibile. Sa i përket matjes, nuk bëhen në mënyrë reale dhe në kohë, sepse përfshihen shumë variabla që e ndryshojnë rezultatin.

Përfshirja e shumë produkteve e zvogëlon përqindjen e inflacionit, ndërsa inflacioni real është më i lartë sesa paraqitet nga ASK", ka thënë profesori i ekonomisë, Shkumbin Misini.

Në agjencitë për patundshmëri theksojnë se një nga faktorët e rritjes së çmimeve është edhe rritja e kërkesave për blerje të banesave, sidomos pas pandemisë.

Edona Cakaj nga "PRO Real Estate" thotë se vetëm në periudhën e fundit të vitit 2025 rritja e çmimit ishte në shkallën 7-8 për qind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024.

"Në periudhën e fundit të vitit 2024: Në shumicën e projekteve çmimet kanë lëvizur rreth 1300–1600 €/m², ndërsa në zonat më të kërkuara shpesh kërkuara 1800–2300 €/m².

Në periudhën e fundit të vitit 2025: në shumicën e projekteve çmimet lëvizin rreth 1400–1700 €/m², ndërsa në zonat më të kërkuara shpesh kalojnë 2000–2500 €/m². Këto janë çmime mesatare dhe ngritja ka qenë nga 2024 në 2025 rreth 7%", ka thënë ajo.

KOHA i është drejtuar edhe ASK-së për këto statistika.

vijon në faqen e tretë

"Heshtja" e institucioneve të trashëgimisë cenon monumentin në Pejë



Ministria e Kulturës është duke kundërshtuar në Gjykatë lejen e ndërtimit që Komuna e Pejës ia ka lëshuar kompanisë "Dukagjini" për ndërtimin e një shumëkatësheje në zonën e mbrojtur të xhamisë "Taftali", e cila mbrohet si monument. Gjykata Themelore për herë të dytë ka vendosur për masë sigurie duke...

Faqe 11